



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planiar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivered	11.10.2023	3 viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot Ri. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKPMSTHCK	6514/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.1077/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1077/2023 të datës 14.08.2023, të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit me nr. protokolli 4016/02-3 të datës 06.07.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "Masë Disiplinore-Largim nga Shërbimi Civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 11.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1077/2023 të datës 14.08.2023, të parashtruar nga ankuesja

Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa të Nëpunësve të Shërbimit Publik të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 14.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5632/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër Vendimit me nr. protokolli 4016/02-3 i datës 06.07.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e njëjta kërkon që vendimi i shqyrtuar largim nga shërbimi civil ndaj saj të shpallet në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe i njëjti të shfuqizohet.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.08.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa Këshilli më datë 28.08.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër VK/2023 me datë 26.09.2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me numër protokollit 5632/2023 të datës 14.08.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga V.E. për ankesa.kpmsk@rks-gov.net i datës 11.08.2023; E-mailin e datës 24.01.2023 nga A.H. për V.E. etj.; Kërkesën për pushim për V.E. për periudhën 19.01.2023-24.01.2023; Raportin e ndërprerjes së përkohshme për punë për V.E. të datës 24.01.2023; Recetë për barna të datës 10.03.2023; Recetën për barna të datës 10.03.2023; Raport specialistik me numër protokollit 3067 të datës 20.03.2023; Udhëzim për konsultim me numër regjistri 2381; Udhëzim për konsultim me numër regjistri 619; Udhëzim për hulumtime diagnostike me numër regjistri 2051 të datës 31.05.2023; Raport specialistik me numër protokollit 2534 të datës 30.05.2023 të SHSKUK-së; Udhëzimin për konsultim me numër regjistri 2381; Udhëzim për konsultim me numër regjistri 1372; Udhëzimin për konsultim me numër regjistri 1371; Udhëzim për hulumtime diagnostike me numër regjistri 1371 të datës 20.03.2023; Udhëzimin për hulumtime diagnostike me numër regjistri 1371; Udhëzimin për konsultim me numër regjistri 1312; Raportin e ndërprerjes së përkohshme të punës të datës 30.05.2023; Shkresë nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës e V.E. e datës 20.11.2023; E-mailin e datës 25.01.2023 të dërguar nga V.E. për A.H. me korrespondim prej faqe 1-3; E-mailin e datës 29.05.2023 të dërguar nga V.E. për A.H. me korrespondim prej faqe 1-2; Inicimin e procedurës për Komisionin Disiplinor me numër protokollit 400/03 të datës 09.06.2023 të MINT; Vendim me numër protokollit 4016/02 të datës 06.07.2023 i Komisionit Disiplinor të MINT; Ankesën e datës 07.07.2023 të parashtruar nga V.E për MINT; Ankesën me numër protokollit 4277/02 të datës 17.07.2023 të parashtruar nga V.E. për MINT; Ankesën me numër protokollit 4278/02 të datës 17.07.2023 të parashtruar nga V.E për MINT; Përgjigje lidhur me ankesën e datës 17.07.2023 me numër protokollit 4305/02 të datës 19.07.2023 nga Sekretari i Përgjithshëm i MINT; Kërkesë për qasje në postën elektronike zyrtare të datës 04.08.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 22.08.2023; Përgjigje në ankesë e datës 28.08.2023; E-mailin e datës 07.12.2022 nga A.D. për V.R.V. me korrespondim prej faqe 1-5; E-mailin e datës 25.01.2023 nga A.D. për V.R.V. etj. me korrespondim prej faqe 1-5; E-mailin e datës 24.05.2023 nga A.H. për A.D. etj. me korrespondim prej faqe 1-4; E-mailin e datës 24.05.2023 nga A.D. për A.H. me korrespondim prej faqe 1-2; Procesverbalin e datës 16.06.2023 të mbajtur nga Seanca e Komisionit Disiplinor të MINT; Procesverbalin e datës 16.06.2023 të mbajtur nga Seanca e Komisionit Disiplinor të MINT; Kërkesën për pushim mjekësor të datës 26.04.2023 të V.E.; Kërkesën për pushim mjekësor të datës 28.04.2023; Kërkesën për pushim mjekësor të datës 28.03.2023; Raportin e ndërprerjes së përkohshme për punë të datës 25.04.2023; Kërkesën për pushim mjekësor të datës 24.03.2023; Raportin e ndërprerjes së përkohshme për punë të datës 16.03.2023; Kërkesën për pushim mjekësor të datës 09.02.2023; Raportin e ndërprerjes së

përkohshme për punë të datës 03.02.2023; Kërkesën për pushim të datës 30.12.2022; Raportin e ndërprerjes së përkohshme për punë të datës 30.12.2022; Kërkesën për pushim për periudhën 05.12.2022-09.12.2022; Raportin e ndërprerjes së përkohshme për punë të datës 13.12.2022; Kërkesën për pushim për datën 07.11.2022; Recetën për barna të datës 07.11.2022 dhe dëftesën me numër 0432916; E-mailin e datës 25.04.2023 nga A.H. për V.E. etj. me korrespondim prej faqe 1-4; E-mailin e datës 16.05.2023 nga A.H. për R.B. etj.; E-mailin e datës 26.05.2023 nga A.H. për V.E. me korrespondim prej faqe 1-2; E-mailin e datës 29.05.2023 nga A.H. për V.E. me korrespondim prej faqe 1-3; E-mailin e datës 30.05.2023 nga V.E. për A.H. me korrespondim prej faqe 1-3; E-mailin e datës 31.05.2023 nga V.E. për A.H. me korrespondim prej faqe 1-4; E-mailin e datës 01.06.2023 nga A.H. për V.E. me korrespondim prej faqe 1-5; E-mailin e datës 05.06.2023 nga A.H. për Z.K. etj. me korrespondim prej faqe 1-4; E-mailin e datës 26.06.2023 nga V.E. për Z.K.; E-mailin e datës 04.07.2023 nga Arkiva Mint për V.E. etj.; Vendim me numër protokolli 465/02 të datës 04.07.2023 të Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MINT; E-mailin e datës 26.06.2023 nga V.E. për Z.K. etj.; E-mailin e datës 07.07.2023 nga B.B për V.E. etj.; Prova shitesë të datës 22.09.2023; E-mailin e datës 20.09.2023 të dërguar nga A.D. për C.Z. me korrespondim prej faqe 1-2; E-mailin e datës 20.09.2023 të dërguar nga C.Z. për A.D. i datës 20.09.2023; Vendim i KPMSHCK me numër VK/2023 me numër protokolli 6267/2023 i datës 26.09.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja **respe:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se bazuar në shkresat e lëndës konkretisht vendimin me numër Ref.02/Nr.168 të datës 04.07.2023, rezulton se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "*Receptioniste*", në kuadër të Departamentit për Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Kolegji i Këshillit i'u referua fillimisht dispozitave të Ligjit N..06/L-114 për Zyrtarët Publikë që kanë qenë në fuqi përkatësisht me nenin 2 ku është përcaktuar se; "*...2.Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.... 6. Nëpunës administrativo-technik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike*". Ndërsa me nenin 82 po të këtij ligji është përcaktuar se "*Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në nenet 79 deri 81 të këtij ligji, marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës*", rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në pozitën e ankueses "*Receptioniste*" në kuadër të Departamentit për Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Kolegji i Këshillit konstatoi se në rastin konkret pozita "*Receptioniste*" është kategorizuar si nëpunës administrativo-technik dhe mbështetës.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, thekson se nëpunësi administrativo-technik dhe mbështetës fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të filloj kontest administrativ në gjykatën kompetente.



Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, sepse Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil.

Andaj duke pas parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1077/2023 të datës 14.08.2023, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesja nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Nëpunësve të Shërbimit Publik të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.*


Andaj pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1077/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të personelit në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

